



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DROPULL

KËSHILLI BASHKIAK

Nr. Prot

Date : 30.04.2026

VENDIM

NR., DATË. 30. 04.2026

PËR

“MIRATIMIN E PËRFITUESVE DHE MASËS MUJORE TË PËRFITIMIT NGA FONDI SHITESË MBI FONDIN E KUSHTËZUAR TË NDIHMËS EKONOMIKE, PËR MUAJI PRILL 2026”.

Në mbështetje të nenit 24, “Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale”, Ligji 139/2015, “Mbivetqeverisjen vendore”, nenit 21,tëLigjit 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”,indryshuar, VKMnr.597,datë 04.09.2019,“Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”,indryshuar, Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.68 date 17.12.2025,“Përmiratimin e kriterëve për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar të ndihmës ekonomike, për familjet dhe individët nënevojë, për vitin 2026”, Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.68, dt.17.12.2025,Keshilli Bashkiak ne mbledhjen e dates 30.04.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

VENDOSI:

1.Miratimin e listës së përfituesve dhe masës mujore të përfitimit nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar të ndihmës ekonomike, për familjet dhe individët nënevojë,për muajin Prill 2026, sipas tabelave bashkangjitur.

2. Ngarkohet Drejtoria e Sherbimeve Sociale dhe e Strehimit për zbatimin e këtij vendimi..

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55 ,pika 6 te ligjit nr.139/2015” Për VetëqeverisjenVendore”).

KRYETAR
Donika BAUÇI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DROPULL
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. Prot

Jergucat më 30 / 04 / 2026

VENDIM

Nr. ___ Date 30.04.2026

Për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” Kryetarit të Bashkisë Agia në Greqi,

z. Antonis Gountaras

Këshilli i Bashkisë Dropull, në mbledhjen e tij të datës 30 / 04/ 2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, sipas shkresës me nr. 692 prot., datë 14 . 04 . 2026, si dhe me Vendimin e Komisionit Këshillimor për dhënien e titujve të nderit, sipas shkresës me nr. 727 prot., datë 21.04. 2026, mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në Rregulloren e Këshillit Bashkiak Dropull, në rregulloren “Për llojet e titujve të nderit, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre”, në ligjin nr. 94/2022 “Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në VKM-në nr. 861, datë 10.12.2014, “Për rregullat e hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”

VENDOSI:

1. Dhënien e titullit “Qytetar Nderi” Kryetarit të Bashkisë Agia në Greqi, z. Antonis Gountaras,

Për mbështetjen e vazhdueshme dhe kontributet konkrete ndaj Bashkisë së Dropullit, duke kontribuar në zhvillimin lokal dhe forcimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërmjet dy Bashkive.

2. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e njoftimit subjektivit të interesuar.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

**Kryetare
Donika Bauçi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DROPULL



RELACION

Për dhënien e titullit Qytetar Nderi Kryetarit të Bashkisë Agia në Greqi

Z. Antonis Gountaras

Këshilli i Bashkisë Dropull në mbledhjen e tij të datës / /2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë shkresa me nr. 692 prot., datë 14 . 04 . 2026 dhe më Vendimin e Komisionit Këshillimor për dhënien e titujve të nderit, sipas shkresës me nr. 727 prot., datë 21.04. 2026, mbështetur në ligjin 139/2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore”, në Rregulloren e Këshillit Bashkiak Dropull, të Rregullores “Për llojet e titujve të nderit, Kriteret dhe Procedurën e Dhënies së tyre” në ligjin nr. 94/2022 “Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në VKM-në nr. 861, datë 10.12.2014, “Për rregullat e hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”

Duke qënë se Këshilli Bashkiak është autoritet përgjegjës për dhënien e titujve vendorë të nderit për shpërblimin e veprimtarisë së shquar të çdo personaliteti shqiptar ose të huaj në dobi të Bashkisë Dropull ose për veprimtari për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të saj, dhe me propozimin e Kryetarit të Bashkisë dhe me vendimin e Komisionit Këshillimor për dhënien e titujve të Nderit, të nderohet Kryetari i Bashkisë Agia në Greqi Z. Antonis Gountaras me titullin “Qytetar Nderi” për mbështetjen e vazhdueshme dhe kontributet konkrete ndaj Bashkisë së Dropullit, duke kontribuar në zhvillimin lokal dhe forcimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërmjet dy bashkive.

K R Y E T A R I

Dhimitraq TOLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DROPULL
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. Prot

Data ,30.04.2026

VENDIM

Nr. , Datë 30.04.2025

“PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT TË KUSHTËZUAR TË BUXHETIT TË SHETIT PËR EMERGJENCAT CIVILE DHE SHTESAVE BUXHETORE, PËR VITIN 2026”.

Në mbështetje të nenit 54, pika “dh”, të ligjit 139/2015, “Për Veteqeverisjen vendore”, ligjit nr.9936,dt.26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, ligjit 68/2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore”, ”, i ndryshuar, nenit 65 të ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, pikës 6, të nenit 15, të ligjit nr.87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, VKM nr.414, datë 08.07.2021, “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, i ndryshuar, pikës 19 të Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave nr.2, datë 14.01.2026, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026”, Shkresës së Ministrisë së Mbrojtjes, AKMC, nr.429/6 prot., datë 15.04.2026, “Mbi fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile për vitin 2026”, Shkresës së Ministrisë së Financave nr.4018 prot., datë 4.03.2026, “ Shpërndarja e grantit të bazuar në performancë me burim financimin e huaj”, Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.67, datë 17.12.2025, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetit të Bashkisë Dropull për vitin 2026, ”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.63, datë 27.11.2025, “Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.41, datë 29.08.2025, “ Për konstatimin dhe vlerësimin e dëmeve për subjektet e evidentuara nga grupi i konstatimit, i ngritur pranë Bashkisë Dropull të shkaktuara nga zjarri masiv i datës 24.07.2025, në fshatin Kakavi, Njësia Administrative Dropull i Sipërm, në vlerë 17.187.287 lek”, Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.04, datë 30.01.2026, “Për miratimin e destinacionit të përdorimit të Grantit të Bazuar në Performancë të vitit 2025, me burim financimin e huaj”, Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr. 11, datë 27.02.2026, “Për miratimin e dëmshpërblimit të familjeve, që pësuat dëme nga zjarri në fshatrat Vrisera (Valandina Ruxho), Sotirë (Arian Niko) dhe nga shiu në Dervician (lefter Baruta), me vlerë 10.583.151,4 lek me TVSH”, Shkresës së Bashkisë Dropull, dërguar AKMC-së, nr.91 prot. datë 15.01.2026, “Kërkesë për financim projekti,”Rehabilitimi i dëmeve nga përmytjet, Nëntor 2025, në Bashkinë Dropull”, në mbledhjen e datës 30.04.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1.Miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për emergjencat civile , për vitin 2026, në vlerë 5.694.189 lek, në kodin e produktit AB, si më poshte:

- a- Mbulim i shpenzimeve për dëmin nga zjarri i datës 24.07.2025, të kasolle, depo, abiente private ndihmëse të znj. Elefteria Lako, ID, E6533101P, në fshatin Kakavi me vlerë 170.057 lek, në artikullin 604, sipas Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.63, datë 27.11.2025

- b- Mbulim i **diferencës** së shpenzimeve për dëmin nga zjarri i datës 24.07.2025, të shtëpisë së z. Hristo Karamano, ID, E90421010W, në fshatin Kakavi me vlerë 1.117.000 lek, në artikullin 604, sipas Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.63, datë 27.11.2025.
- c- Mbulim i nj; pjese të shpenzimeve për dëmin nga zjarri i datës 29.01.2026, të shtëpisë së z. Andon Niko, ID, E207170170, në fshatin Sotirë, me vlerë 3.400.560 lek, në artikullin 604, sipas Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr. 11, datë 27.02.2026.
- d- Mbulim i një pjese të shpenzimeve për dëmin tek biznesi (hotel), me NIPT L02512601T, nga zjarri i datës 02.02.2026, të znj. Valendina Ruxho, ID, G25506019E, në fshatin Vrisera, me vlerë 1.006.572 lek, në artikullin 604, sipas Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr. 11, datë 27.02.2026.

2.Miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për emergjencat civile , për vitin 2026, në vlerë 5.694.189 lek, në kodin e produktit AD, artikullin 231, si më poshte:

- Riparim i dëmeve në objektin “Mbrojtje nga Përroi i Selos, Dropull -Faza I“ dhe në segmentet rrugorë Likomil-Selo-Klishar.

3.Miratimin e shtesave buxhetore, si me poshte:

B. Të shtohen të ardhurat:

Nga granti i bazuar në performance, me burim financimin e huaj, në Kapitullin 2, në vlerë 6.555.450 lek.

B. Të Shtohen shpenzimet:

-Gr.00.Tit. 04260 .Kap.2. Art . 230 per	5.888.004 lek
-Gr.00.Tit. 04260 .Kap.2. Art . 602 per	667.446 lek

4. Ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 te ligjit nr.139/2015” Për Vetëqeverisjen Vendore”).

KRYETAR

Donika BAUÇI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DROPULL



Nr. ____ prot.

Jergucat, më: ____ . ____ .2026

MIRATOHET
KRYETARI

Dhimitraq TOLI

PLAN MASASH
PËR

PARANDALIMIN, PËRGATITJEN, MBROJTJEN DHE PËRGJIGJEN NDAJ SITUATAVE TË MUNDSHME TË KRIJUARA SI PASOJË E TEMPERATURAVE TË LARTA PËR PERIUDHËN PRANVERË-VERË 2026

I. BAZA LIGJORE

Ligj nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”

Ligj nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar

Ligj nr. 152/2015, datë 21.12.2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”

Ligj nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, i ndryshuar

Ligj nr. 57/2020 “Për Pyjet”

VKM nr. 807, datë 28.12.2023 “Për miratimin e Planit Kombëtar për Emergjencat Civile”

VKM nr. 965, datë 02.12.2015 “Bashkëpunim Ndërinstitucional të Strukturave të Drejtimit në rastet e emergjencave civile dhe krizave”

Udhëzim Nr. 16, datë 11.07.2003 “Për ngritjen e Komisionit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile në nivel Qarku”

II. SITUATA

Hartohet ky plan masash me qëllim parandalimin, evidentimin, bashkërendimin midis institucioneve dhe ndërhyrjen në kohën sa më të shkurtër në fikjen e një vatre zjarri të munshme në territorin e Bashkisë Dropull. Gjatë vitit 2026 në Bashkinë Dropull kemi patur 5 vatra zjarri ku 1 në fondin pyjor dhe 4 në fondin kullosor ku si pasojë janë përshkuar nga zjarri 8,66 ha sipërfaqe pyjore dhe 48.2 ha sipërfaqe kullosore, gjithashtu nga zjarri janë djegur 3 shtëpi banimi dhe 0.1 ha vresht në fshatin Kakavi.

Për të shmangur situatat e zjarreve që mund të shfaqen gjatë periudhës së nxehtë puna do të përqëndrohet në zbatimin e detyrave të mëposhtme:

III. PARANDALIMI DHE PËRGJEGJIA NDAJ SITUATAVE EMERGJENTE QË NUND TË KRIJOHEN NGA FENOMENET TË TË GJITHA NATYRAVE QË KARAKTERIZON STINËN E PRANVERËS.

1. PARANDALIMI I SITUATAVE EMERGJENTE QË MUND TË KRIJOHEN NGA FENOMENET NATYRORE, POR DHE NATYRAVE TË TJERA.

Objektivat, detyrat, masat për tu ndërmarrë, afatet dhe përgjegjësia					
Nr.	Objekti / Detyrat	Veprimet / Masat për tu ndërmarrë		Afati	Përgjegjësia
	Ngritja e grupit të përhershëm të punës, planifikimit, përballimit të emergjencave civile dhe krizave në	Përbërja e grupit: Thanas Kuremeno Panajot Dhefto	Kryetar Anëtar		Kryetari i bashkisë

1	bashki, me Urdhrin nr. 14 datë 07.01.2026 të kryetarit të Bashkisë.	<table border="0"> <tr> <td>Gligor Dushi</td> <td>Anëtar</td> </tr> <tr> <td>Arian Tusha</td> <td>Anëtar</td> </tr> <tr> <td>Alqiviadh Kosta</td> <td>Anëtar</td> </tr> <tr> <td>Jani Panajoti</td> <td>Anëtar</td> </tr> <tr> <td>Kristaq Dhima</td> <td>Anëtar</td> </tr> <tr> <td>Kosta Kazaqi</td> <td>Anëtar</td> </tr> <tr> <td>Jorgji Kokollo</td> <td>Anëtar</td> </tr> </table>	Gligor Dushi	Anëtar	Arian Tusha	Anëtar	Alqiviadh Kosta	Anëtar	Jani Panajoti	Anëtar	Kristaq Dhima	Anëtar	Kosta Kazaqi	Anëtar	Jorgji Kokollo	Anëtar	I përhershëm	Kryetari i grupit
Gligor Dushi	Anëtar																	
Arian Tusha	Anëtar																	
Alqiviadh Kosta	Anëtar																	
Jani Panajoti	Anëtar																	
Kristaq Dhima	Anëtar																	
Kosta Kazaqi	Anëtar																	
Jorgji Kokollo	Anëtar																	
2	Shmangia e situatave të emergjencave civile dhe zvogëlimi i përpikshmërisë sociale, ekonomike dhe mjedisore që mund të shkaktohen nga fenomenet natyrore që karakterizojnë stinën e pranverës dhe verës.	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Informacion të ndërsjellë midis strukturave të Bashkisë, monitorimit dhe vlerësimit në lidhje me situatat e zjarreve. ✓ Monitorimi në mënyrë të vazhdueshme të territorit për dukuritë e shfaqjes së zjarreve ✓ 	Gjatë gjithë kohës	Kryetari i Bashkisë Kryetari i grupit Drejtoria e MZSH Dropull Institucionet e Bashkisë														
3	Ngritja në cdo fshat të bashkisë i skuadrave vullnetare zjarrëfikse, të gatshëm për të ndihmuar në zbulimin, izolimin dhe fikjen e një vatre të mundshme zjarri.	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Ngritja e grupeve vullnetare për cdo fshat, ✓ Trajnimi i tyre. ✓ Paisja me mjetet e nevojshme për ndërhyrje të shpejtë. 	Periudha Maj - Qershor	Drejtoria e MZSH-së Drejtoria e AUPLK-së Administratorët e NjQV-ve														
4	Përcaktimi i roleve e përgjegjësive të qarta të drejtorive të Bashkisë për parandalimin e situatave të emergjencave civile që mund të krijohen nga fatkeqësitë e të gjitha natyrave gjatë stinës së pranverës dhe verës.	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Analizë e gjëndjes së planifikimit dhe përballimit të emergjencave civile në bashki, sipas fushës së përgjegjësive që ka në lidhje me problematikat që mund të vijnë si pasojë e zjarreve. 	Mars-Qershor	Kryetari i Bashkisë Grupi i përhershëm i punës, planifikimit, përballimit të emergjencave civile dhe krizave në bashki..														

5	Plane për përballimin e emergjencave civile që mund të krijohen gjatë stinëve të pranverës dhe verës, kjo e lidhur dhe me faktin e shtimit të fluksit të banorëve të ardhur për pushimet verore.	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Hartimi i planit të masave për parandalimin, përgatitjen, mbrojtjen dhe përgjigjen ndaj situatave që mund të shkaktohen nga zjarret. ✓ Përditësimi i planeve të gatishmërisë për përballimin e situatave emergjente që mund të krijohen nga zjarret por jo vetëm. 	Maj Maj	Kryetari i Bashkisë Grupi i përhershëm i punës, planifikimit, përballimit të emergjencave civile dhe krizave në bashki..
6	Sigurimi i shërbimit shëndetësor për zonat që mund të preken nga ngjarjet emergjente.	✓ Sigurimin e gatishmërisë të autoambulancës në bashki për ndihmën e parë dhe bashkërendimi me Drejtorinë Shërbimit Shëndetësor.	Në çdo kohë	Grupi i përhershëm i punës, planifikimit, përballimit të emergjencave civile dhe krizave në bashki..
7	Sigurimi i fondeve të nevojshme për situatat e mundshme që mund të krijohen nga zjarret.	✓ Sigurimi i fondeve financiare, alokuimin e tyre në kohë për ndërhyrjen e forcave e të mjeteve në operacionet emergjente të nevojshme për shkak të situatave që mund të krijohen nga zjarret.	Sipas situatave gjatë periudhës Mars-Qershor	Kryetari i Bashkisë Grupi i përhershëm i punës, planifikimit, përballimit të emergjencave civile dhe krizave në bashki..
8	Informimi dhe ndërgjegjësimi i publikut.	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Sensibilizimi i opinionit publikime të gjitha format, në mënyrë që të rritet ndërgjegjësimi i tyre për rrezikun që vjen si pasojë e ngjarjeve në stinët pranverë-verë, me qëllim, mbrojtjen e shëndetit dhe pronës së tyre. ✓ Bashkëpunim me mediat lokale, pasqyrimi në rrjetet sociale për rreziqet me qëllim sensibilizimin e komunitetit. ✓ Realizimi i funksionimit të sistemit të monitorimit, paralajmërimit të hershëm, njoftimit dhe alarmit. 	Gjatë periudhës Mars – Qershor Qershor Sipas situatave	Drejtoria e MZSh-së Dropull Grupi i përhershëm i punës, planifikimit, përballimit të emergjencave civile dhe krizave në bashki..
		✓ Kontrolli i gatishmërisë së automjeteve, mjeteve dhe pajisjeve të forcave zjarrfikëse.	E vazhdueshme Qershor	Drejtoria e MZSh-së Dropull

9	Gatishmëria e forcave, mjeteve dhe pajisjeve zjarrfikëse.	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Kontrolli për marrjen e masave për mbrojtjen nga zjarri në institucione publike e objekte biznesi. ✓ Kontrolli dhe vënia në gatishmëri i pompave thithëse hidrovorëve por dh i hidrantëve dhe vëndeve të furnizimit me ujë të automjeteve zjarrfikëse. 	Mars - Qershor	Grupi i përhershëm i punës, planifikimit, përballimit të emergjencave civile dhe krizave në bashki..
10	Trajnime.	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Organizimi i trajnimeve me: <ul style="list-style-type: none"> • Grupin emergjent të ngritur në bashki për situatat që nuk mund të përballohen nga trupat e shërbimit zjarrfikës. • Njësitë vullnetare në njësitë administrative. • Me shfrytëzuesit e pyjeve e të kullotave në teritorin e bashkive. 	Maj Sipas grafikut	Drejtoria e MZSh-së Dropull Grupi i përhershëm i punës, planifikimit, përballimit të emergjencave civile dhe krizave në bashki..

2. PËRGJIGJIA NDAJ SITUATAVE EMERGJENTE QË MUND TË KRIJOHEN NGA ZJARRET

Objektivat, detyrat, masat për tu ndërmarë, afatet dhe përgjegjësia				
Nr.	Objekti / Detyrat	Veprimet / Masat për tu ndërmarë	Afati	Përgjegjësia
1	Sigurimi i jetës njerëzore	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Rritja e gadishmërisë, lajmërimi i shpejtë sipas rastit i popullsisë dhe dhënia e informacionit të ndërsjellë për shkak të ngjarjeve të periudhës së pranverës (në fokus përmbytjet por dhe zjarret). 	Gjatë gjithë periudhës Mars Qershor, sipas situatave	Drejtoria e MZSh-së Dropull Grupi i përhershëm i punës, planifikimit, përballimit të emergjencave civile dhe krizave në bashki.

2	Evakuimi.	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Evakuimi i popullsisë në rast nevojave, me qëllim mbrojtjen e jetës, gjësë së gjallë dhe pasurisë në qendrat e pritjes dhe grumbullimit të caktuara sipas planeve. 	Sipas situatave	Drejtoria e MZSh-së Dropull Grupi i përhershëm i punës, planifikimit, përballimit të emergjencave civile dhe krizave në bashki..
3	Ruajtja e shëndetit të popullsisë.	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Sigurimi i shërbimit të ambulancës dhe të emergjencës mjekësore për zonën e prekur nga fatkeqësitë për dhënien e ndihmës së parë dhe transportin e të dëmtuarave në qendrat shëndetësore e spitalore. 	Gjatë gjithë periudhës	Drejtoria e MZSh-së Dropull Grupi i përhershëm i punës, planifikimit, përballimit të emergjencave civile dhe krizave në bashki..
4	Ruajtja e rendit dhe sigurisë.	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Marrja e masave për ruajtjen e rendit dhe sigurimin e zonave të prekura nga zjarret. ✓ Organizimi i kërkimit dhe shpëtimit në rast neviqe. ✓ Bashkëpunimi në mënyrë të veçantë me strukturat e Policisë së Shtetit në ruajtjen e rendit. 	Gjatë gjithë periudhës Sipas situatave E vazhdueshme	Drejtoria e MZSh-së Dropull Grupi i përhershëm i punës, planifikimit, përballimit të emergjencave civile dhe krizave në bashki. Drejtoria e Policisë,

5	Reagimi ndaj situatave të krijuara nga zjarret.	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Vlerësimi i situatave, caktimi i drejtuesve të operacioneve në përballimin e situatave emergjente. ✓ Marrja e informacionit peridik dhe rast pas rasti, mbi situatën e ngjarjeve emergjente në teritorin e Bashkisë dhe angazhimin e menjëhershëm të strukturave të MC. ✓ Vënia në dispozicion të operacioneve gjatë ndërhyrjes të burimeve e kapaciteteve njerëzore e logjistike. ✓ Kordinimi sipas shkallës së fatkeqësisë i forcave operacionale për ndërhyrjen në kohë dhe përballimin e situatës. ✓ Kërkimi i ndihmës në nivel qendror e vendor kur situatat e krijuara nga zjarret janë përtej mundësive të bashkise. ✓ Në varësi të situatave, ndërprerja e përkohëshme e energjisë dhe sigurimi i saj në zonat e emergjencës. 	<p>Sipas situatave</p> <p>Gjatë gjithë periudhës</p> <p>E vazhdueshme</p> <p>Sipas situatave</p> <p>Sipas situatave</p> <p>Sipas situatave</p>	<p>Prefekti qarkut</p> <p>Kryetari i Bashkisë</p> <p>Grupi i përhershëm i punës, planifikimit, përballimit të emergjencave civile dhe krizave në bashki.</p> <p>Drejtoria e MZSh-së Dropull</p>
---	-------------------------------------------------	----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

V. TË NDRYSHME

Objektivat, detyrat, masat për tu ndërmarë, afatet dhe përgjegjësia				
Nr.	Objekti / Detyrat	Veprimet / Masat për tu ndërmarë	Afati	Përgjegjësia
1	Konstatime dhe vlerësime.	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Krijimi i grupimeve të konstatimit dhe vlerësimit të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë në zonat e prekura. ✓ Plotësimi i dokumentacionit për të drejtën e kompesimit sipas VKM Nr. 329 	Sipas situatave	Grupi i përhershëm i punës, planifikimit, përballimit të emergjencave civile dhe krizave në bashki. Drejtoria e Urbanistikes Drejtoria AUPLK-së
2	Raporte e informacione.	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Hartimi i raporteve dhe informacioneve periodike për situatat dhe dërgimi në mënyrë të vazhdueshme në prefkturë dhe QKOMC. 	Qershor-Shtator	Grupi i përhershëm i punës, planifikimit, përballimit të emergjencave civile dhe krizave në bashki. Drejtoria AUPLK-së
3	Vlerësimi i nevojave dhe shpërndarja e ndihmave.	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Vlerësimi i nevojave, kërkesat për mbështetje, organizimi, pritja dhe shpërndarja e ndihmave popullsisë së prekur nga fatkeqësia. 	Sipas situatave	Grupi i përhershëm i punës, planifikimit, përballimit të emergjencave civile dhe krizave në bashki.

KRYETARI
I GRUPIT TË PËRHERSHËM TË PUNËS, PLANIFIKIMIT,
PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE NË BASHKINË DROPULL
Thanas KUREMENO



R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
BASHKIADROPULL
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. prot

Date 30.04.2026

V E N D I M

Nr. Date 30.04.2026

PËR

**“RIEMERTIMIN E SHKOLLES 8-VJECARE SKORE,NGA “PANDELI DALLAS”
NE ISH SHKOLLA 8 VJECARE “PANDELI DALLAS”,QENDER ETNOLOGJIKE
KULTURORE SKORE”.**

Ne baze te Nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1/1.1, shkronja b) dhe pika 1/1.7 shkronja b), nenit 54 shkronja ll) dhe nenit 55 pikat 2 dhe 6 të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, me proprozim te kryesise se fshatit dhe te shoqates “ Lindja e Virgjereshes Mari”,Skore, Keshilli Bashkiak ne mbledhjen e dates 30.04.2026

VENDOSI:

1. RIEMERTIMIN E SHKOLLES 8-VJECARE SKORE,NGA “PANDELI DALLAS” NE ISH SHKOLLA 8 VJECARE “PANDELI DALLAS”,QENDER ETNOLOGJIKE KULTURORE SKORE”.
2. Per zbatimin e vendimit ngarkohet Drejtoria e Sherbimeve Publike.
3. Ky vendim hyn ne fuqi nga dita e njoftimit subjektit te interesuar.

K R Y E T A R

DONIKA BAUCI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DROPULL
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. ____ Prot

Date 30.04.2026

VENDIM

Nr. _____, datë 30.04.2026

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MASAVE PËR PARANDALIMIN, PËRGATITJEN,
MBROJTJEN DHE PËRGJIGJEN NDAJ SITUATAVE TË MUNDSHME TË KRIJUARA
SI PASOJË E TEMPERATURAVE TË LARTA PËR PERIUdhËN
PRANVERË-VERË 2026”**

Në mbështetje të Ligjit nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr. 152/2015, datë 21.12.2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, Ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, i ndryshuar, Ligjit nr. 57/2020 “Për Pyjet”, VKM-së nr. 807, datë 28.12.2023 “Për miratimin e Planit Kombëtar për Emergjencat Civile”, VKM-së nr. 965, datë 02.12.2015 “Bashkëpunim Ndërinstitucional të Strukturave të Drejtimit në rastet e emergjencave civile dhe krizave” dhe Udhëzimit Nr. 16, datë 11.07.2003 “Për ngritjen e Komisionit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile në nivel Qarku”. Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 30.04.2026 me propozim të Kryetarit të Bashkisë

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të masave për parandalimin, përgatitjen, mbrojtjen dhe përgjigjen ndaj situatave të mundshme të krijuara si pasojë e temperaturave të larta për periudhën pranverë-verë 2026”.
2. Per zbatimin e këtij vendimi ngarkohet e grupi i përhershëm i punës, planifikimit, përballimit të emergjencave civile dhe krizave në Bashki, sipas Urdhrit nr. 14 datë 07.01.2026 të kryetarit të Bashkisë.
3. 5. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të ligjit nr.139/2015” Për Vetëqeverisjen Vendore”).

KRYETARI I KËSHILLIT

Donika BAUÇI